

 OPEN SOCIETY INSTITUTE  
EU MONITORING AND ADVOCACY PROGRAM

 OPEN SOCIETY INSTITUTE  
MEDIA PROGRAM

 Instituti Shqiptar i Medias  
Albanian Media Institute

Teksti i plotë i këtij raporti gjendet në  
<http://www.eumap.org/reports/2005> dhe në  
<http://www.institutemedia.org>.

Për më tepër informacion ju lutem  
kontakttoni Ilda Londo:  
[ilda@institutemedia.org](mailto:ilda@institutemedia.org) ose +355 4 229800,  
ose Miriam Anati e OSI Budapest,  
[manati@osieurope.org](mailto:manati@osieurope.org), + 36 30 2748533.

## Për përdorim të menjëhershëm

### Shqipëria: Rreth 257 media, por çfarë shfaqet në TV?

*Tiranë dhe Budapest, 21 nëntor 2005* – Radio-Televizioni Shqiptar (TVSH) ka nevojë të ngutshme restrukturimi. Transmetuesit televizivë privatë në Shqipëri kanë pasur një përparim të dukshëm, megjithëse tregu dhe mënyra e funksionimit të tij mbeten kaotike. Organi rregullator kombëtar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT), ka fuqi zbatuese të kufizuara dhe nuk ka burime të mjaftueshme. Gazetarët në Shqipëri punojnë në kushte të vështira profesionale.

Këto janë konstatimet kryesore të raportit kombëtar për Shqipërinë në serinë e monitorimit **Televizioni në Europë: rregullimi, politikat dhe pavarësia**, e promovuar sot në Tiranë. I prodhuar nga Open Society Institute (OSI) në bashkëpunim me Institutin Shqiptar të Medias, raporti sjell një analizë të detajuar të gjendjes së transmetimeve në Shqipëri. Gjithashtu ai formulon 28 rekomandime konkrete që kanë për qëllim ta sjellin sektorin televiziv në të njëjtën linjë me standartet ndërkombëtare dhe me nevojat e qytetarëve në vend.

Transmetuesi i shërbimit publik - TVSH – përballet me shumë vështirësi. Duke mbuluar 73 përqind të territorit të vendit, ai mund të shihet nga më shumë njerëz se çdo transmetues tjetër, megjithatë shikueshmëria e tij ka mbetur mbrapa në krahasim me stacione të tjera private. Programacioni kulturor dhe edukativ i RTSH – i cili është jetësor për misionin e shërbimit publik që ai ka – është kritikuar vazhdimisht si i pamjaftueshëm. RTSH shpesh akuzohet për njëanshmëri kundrejt qeverisë. Presioni politik mbi RTSH mund të jetë i mprehtë, sidomos në momente delikate si janë fushatat elektorale.

Përkrahja ndërkombëtare për restrukturimin e RTSH është e papërfillshme – në 2004 arrinte deri në € 15,000, sipas Alfred Dalipit, ish-Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm i RTSH. Shuma e të ardhurave nga taksa për televizorin mbetet e paqartë, edhe pse qëllimi i saj është të sigurojë burimin kryesor të të ardhurave për RTSH. Vitet e fundit më tepër se gjysma e buxhetit të RTSH ka ardhur drejtpërdrejt nga buxheti i shtetit dhe mënyra e përdorimit të tij nuk ka qenë gjithnjë transparente.

Raporti i OSI i bën thirrje qeverisë ta transformojë RTSH në një transmetues të vërtetë të shërbimit publik, duke qartësuar rolet dhe përgjegjësitë dhe duke garantuar transparencën e administrimit. Ky debat duhet të përfshijë gazetarët e RTSH, drejtorët e tanishëm dhe të kaluarit, autoritetin rregullator (KKRT), OJQ, si dhe komunitetin e gazetarisë në përgjithësi.

Ky raport, më i ploti që është botuar për transmetimin në Shqipëri, përshkruan gjithashtu rritjen e shquar që ka pësuar transmetimi privat që nga fillimet e veta në 1995. Shqipëria, një vend prej 3.5

milion njerëzish, ka sot rreth 257 media. Duke pasur parasysh madhësinë dhe gjendjen e tregut, këto shifra janë jashtëzakonisht të larta.

Të ardhurat nga reklama për sektorin televiziv në 2003 ishin €6.57 milion, sipas një raporti të botuar nga Qendra Shqiptare për Monitorimin e Medias. Pra, tregu i transmetimeve është larg të qenit financiarisht i vetëmjaftueshëm. Rregullatori kombëtar bëri me dije se në 2003 49 përqind e të ardhurave të stacioneve vinte nga burime të panjohura dhe se asnjë stacion nuk pati fitim. Megjithatë, shumë pak stacione janë mbyllur. Ekonomia politike e transmetimit privat mbetet një mister.

Transparenca efektive e pronësisë nuk garantohet me ligj. Investuesit e huaj nuk kanë pasur interesa të mjaftueshme për të investuar në tregun mediatik shqiptar, gjë e cila shpjegon dhe nivelin e ulët të investimeve të huaja. Nuk ka kufizime për pronësinë e ndërthurur të mediave të shkruara me ato elektronike. Mungesa e të dhënave të besueshme të audiencës nxiti kaosin në tregun e reklamës. Në disa raste qeveritë përdorin fonde publike për të ngritur të ardhurat nga reklama e transmetuesve të favorizuar.

Përgjegjësitë teknike dhe ato të vendosjes së standarteve të organit rregullator kryesor, Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT), janë të përcaktuara shumë gjerë; ai ka kapacitet të dobët zbatues dhe nuk ka burimet e mjaftueshme. Në kohën që ky rregullator u krijua në 2000 shumë transmetues privatë funksiononin dhe nuk patën prirje për të mirëpritur apo respektuar rregullimin.

Gazetarët në Shqipëri punojnë në kushte të vështira profesionale, shpesh pa kontrata. Nuk ekzistojnë mekanizma efikase të vetë-rregullimit dhe vetë-censura shpesh shfaqet me perceptimin e ndonë rreziku të mundshëm.

### **Shënim për redaktorët**

Ky raport është pjesë e një serie raportesh nga 20 vende të ndryshme që monitorojnë *“Televizioni në Europë: rregullimi, politikat dhe pavarësia”*. Raportet u përgatitën nga EUMAP, Programi i BE për Monitorim dhe Avokaci i Open Society Institute, në bashkëpunim me Network Media Program të OSI. Të gjitha raportet gjenden online në adresën <http://www.eumap.org>. Më tepër informacion rreth Open Society Institute gjendet në adresën <http://www.soros.org>.

Raporti mbi Shqipërinë u zhvillua në bashkëpunim me Institutin Shqiptar të Medias (ISHM). ISHM u krijua në 1995. Pas gati një dekade, ISHM është për momentin një nga aktorët kryesorë të shoqërisë civile në Shqipëri si dhe një institucion i njohur trajnimi për gazetarët në rajonin e Ballkanit. Gjithashtu ISHM është e angazhuar në dhe moderon debate mbi politikat për mediat, legjislacionin e medias, studime për median, etj. Më tepër informacion mbi ISHM gjendet në <http://www.institutemedia.org>.